

Sigurimi i Jetës për Kreditë Hipotekare

Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, kalon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.

Sigurimi i Jetës për Kreditë Hipotekare ofron mbulim në rast të humbjes së Jetës së personit të siguruar kredimarrës për shkaqe natyrore apo aksidentale. Në këto raste shoqëria e sigurimit do ti paguajë bankës, për llogari të kredimarrësit, shumën e mbetur të principalit për kredinë e përcaktuar në police pranë Bankës së Tiranës në kohën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Karakteristikat e sigurimit të jetës për kreditë hipotekare:

Ky Sigurim është një garanci financiare si për banken (nga rreziku i mos shlyrjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.

I siguruari është kredimarrësi i cili ka marrë kredi hipotekare pranë Banka e Tiranës, me moshë nga 18 deri në 70 vjeç.

Shuma e sigurimit është shuma e kredise dhe përcaktohet në police sipas planit të amortizimit të kredisë deri në maturim të saj.

Primi i sigurimit paguhet në emer të kredimarrësit dhe përllëgaritet duke marrë në konsideratë moshën, gjininë dhe vlerën e mbetur të kredisë dhe paguhet në baza vjetore.

Kohëzgjatja e policës është për 1 vit dhe rinovohet çdo vit deri në maturimin e kredisë.

Përfitimi i pagueshëm është shuma e mbetur e kredisë në datën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, sipas tabelës së amortizimit të kredisë dhe paguhet në vlerë monetare nga Kompania e Sigurimit në rast vërtetimit të ngjarjes së siguruar.

Individët që nuk sigurohen:

- Individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoja, sindroma organiko-cerebrale;
- Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm;
- Individë mbi 70 vjeç dhe më të rinj se 18 vjeç.

Njoftimi i ngjarjes duhet të kryhet me shkrim drejt shoqërisë së sigurimit nga brokeri brënda 30 ditëve nga data që merret dijeni nga pasjetuesit për ngjarjen.

Kushtet e përgjithshme të sigurimit shoqërojnë çdo policë sigurimi dhe duhen disponuar, kuptuar dhe pranuar nga i Siguruari.